



Financuar nga
Bashkimi Evropian

Ndërtimi i Partneritetit mbi
Çështjet Themelore: Fuqizimi i
OSHC-ve për procesin e
anëtarësimit në BE

THIRRJE PËR PUBLIKIME

Hulumtime Politikash



Financuar nga
Bashkimi Evropian

Çfarë përfshin kjo thirrje >

a\ Tematikat

Lëvizja Europiane në Shqipëri ndan me ju thirrjen për publikime të hulumtimeve të politikave mbi tre kapituj të acquis së BE-së dhe nënçështjet përkatëse me fokus te procesi i anëtarësimit në BE, në kuadër të projektit “Ndërtimi i Partneritetit mbi Çështjet Themelore: Fuqizimi i OSHC-ve për procesin e anëtarësimit në BE”.

Kapitulli 5 - Prokurimet Publike

Kapitulli 18 - Statistikat

Kapitulli 32 - Kontrolli Financiar



Financuar nga
Bashkimi Evropian

Dërgo punimin tënd nëse >

b\Kritere për aplikim

- 1 Ke përfunduar studimet universitare ose pasuniversitare në fushat si: Drejtësia, Shkenca Sociale, Shkenca Politike, Marrëdhënie Ndërkombëtare, apo të ngjashme.
 - 2 Zotëron të paktën 3 vite eksperiencë në institucione/organizata, puna e të cilave përputhet me një nga tematikat e thirrjes.
 - 3 Zotëron njohuri dhe je i/e angazhuar apo interesuar për fushat që përfshihen në Kapitullin 5, 18 dhe 32.
- Për të gjitha publikimet që do të përzgjidhen dhe do të botohen do të ofrohet një shpërblim monetar për autorët.



Financuar nga
Bashkimi Evropian

c/ Udhëzime për shkrimin

- 1 Punimi duhet të jetë vepër origjinale e autorit/es dhe duhet të ndjekë të gjithë rregullat e shkrimit akademik për vendosjen dhe referimin e burimeve dhe bibliografisë (citimi i burimeve sipas formatit APA).
- 2 Punimi duhet të jetë 8-15 faqe, A4, me formatin standard (Times New Roman 12, single space).
- 3 Pranohen punime në njërën nga gjuhët (shqip ose anglisht), por kërkohet që të respektohen rregullat standarde të drejtshkrimit.
- 4 Punimi nuk duhet të jetë publikuar më parë në shtyp apo në mënyrë elektronike.



Financuar nga
Bashkimi Evropian

Udhëzime për dërgimin e punimit >

c\Aplikimi juaj

- 1 Abstrakt ku të specifikohet qartë tema dhe objektivat e synuar, metodologjia e përdorur e kuadri teorik, si dhe çështjet që do të trajtohen (skema dhe struktura e studimit).
- 2 CV e autorit(es) apo bashkëautorëve
- 3 Një publikim i mëparshëm do të konsiderohet vlerë e shtuar për vlerësimin e aplikimit.

Ju ftojmë të dërgoni propozimet tuaja brenda datës 28 janar 2026 në adresën e e-mailit: info@em-al.org